



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
AGJENCIA PËR INFORMIM DHE PRIVATËSI
AGENCIJA ZA INFORMACIJE I PRIVATNOST
INFORMATION AND PRIVACY AGENCY



Nr.123/2026

Datë: 07.07.2026

Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyrtari i Inspektimit, duke vepruar në pajtim me nenin 68, nenin 69, paragrafi 1, nenin 71, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 dhe 1.6 si dhe nenin 92, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pas shqyrtimit të njoftimit të pranuar me datë 10.04.2026, dhe të regjistruar me nr.pro.352, ndaj Komunës së Prishtinës - Inspektoratit të Kryeqytetit, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shqiptohet gjobë në vlerë prej **20,000.00 € (njëzetmijë euro)** ndaj Komunës së Prishtinës, në cilësinë e kontrolluesit, me adresë Rr. “UÇK”, Nr.2. Prishtinë, për shkak të përpunimit të dhënave personale pa bazë ligjore dhe në kundërshtim me parimet e përpunimit të të dhënave personale.
2. Urdhërohet Komuna e Prishtinës që,– Inspektorati i Kryeqytetit, të largojë nga llogaria zyrtare në platformën Facebook, çdo të dhënë personale të subjektit të të dhënave që vazhdon të jetë publikisht e qasshme, përfshirë fotografinë e tij, dhe të sigurojë që kopjet e të njëjtit publikim nën kontrollin e saj të mos mbeten të qasshme për publikun.
3. Obligohet kontrolluesi, që shumën e përcaktuar nga pika 1 e këtij vendimi, ta paguajë në afat prej 30 ditësh, në xhirollogarinë e Agjencisë për Informim dhe Privatësi Nr. 1000400070005127/ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.
4. Me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, i njëjti kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Përmbartuesi Privat.
5. Obligohet kontrolluesi, që brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e hyrjes në fuqi të vendimit të njoftojë Agjencinë me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e pranimit.

Arsyetim

Agjencia për Informim dhe Privatësi (Agjencia), më datë 10.04.2026 ka pranuar njoftim lidhur me publikimin e paaautorizuar të të dhënave personale nga ana e Inspektoratit të Komunës së Prishtinës, përmes një postimi publik në llogarinë zyrtare “Inspektorati i Kryeqytetit” në platformën sociale Facebook. Sipas informacionit të pranuar, në postimin e publikuar është ekspozuar një gjobë e cila përmban të dhëna personale të një individi, duke përfshirë: emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal, numrin e telefonit, adresën, targat e motoçikletës, si dhe fotografinë e personit. Provat përkatëse (screenshots) janë bashkangjitur në njoftim, ndërsa postimi i publikuar gjendet në linkun përkatës <https://www.facebook.com/share/p/1HyLLA8PR3/>.

Bazuar në nenin 68, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP), Agjencia ka filluar procedurën e shqyrtimit të njoftimit për të vërtetuar pretendimet e palës ankuese. Fillimisht, zyrtari i inspektimit ka hulumtuar linkun e bashkangjitur në njoftim, me qëllim të verifikimit të pretendimeve të paraqitura. Gjatë këtij hulumtimi është konstatuar se Inspektorati i Kryeqytetit, në llogarinë zyrtare në platformën “Facebook”, ka publikuar njoftimin me përmbajtje: *“Njoftohen qytetarët se qarkullimi i trotineteve dhe motoçikletave në shesh është i ndaluar. Ky ndalim ka për qëllim rritjen e sigurisë për këmbësorët dhe ruajtjen e rendit publik në hapësirat publike. Të gjithë shkelësit e këtij ndalimi do të gjobiten në përputhje me legjislacionin në fuqi”*. Megjithatë, krahas mesazhit informues, është bërë publik edhe dokumenti konkret i gjobës me të dhëna që mundësonin identifikimin e drejtpërdrejtë të personit. Në kuadër të këtij publikimi, është konstatuar se fotografia e personit fizik vazhdon të ishte e publikuar në mënyrë të qasshme për publikun, ndërsa të dhënat personale të përfshira në gjobën e publikuar ishin anonimizuar. Fakti se një pjesë e të dhënave është anonimizuar më vonë nuk e eliminon përpunimin e kundërligjshëm të kryer me publikimin fillestar dhe as pasojat e ekspozimit të tyre ndaj një numri të pakufizuar përdoruesish.

Agjencia përmes zyrtareve të inspektimit, më datë 20.04.2026, i’u është drejtuar zyrtarit përgjegjës përmes postës elektronike (e-mail), duke kërkuar sqarime lidhur me bazën ligjore të këtij publikimi dhe qëllimin e publikimit. Megjithatë, edhe përkundër ri-kërkesës nga ana e Agjencisë, kontrolluesi nuk ka ofruar asnjë përgjigje, duke treguar mungesë bashkëpunimi institucional.

Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (LMDhP) përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit. LMDhP, në nenin 3, paragrafin 1.1 ka përcaktuar se me të dhëna personale nënkuptojmë çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (“subjekt i të dhënave”) një person fizik i identifikueshëm është ai, i cili, mund të identifikohet drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt, veçanërisht duke iu referuar një identifikuesi në bazë të një emri, një numri identifikimi, të dhënave rreth vendndodhjes, një identifikues online, ose një apo më shumë faktorë specifikë për identitetin fizik, psikologjik, gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose social të atij personi fizik.

Sa i përket përcaktimit të kontrolluesit, Agjencia vlerëson se Inspektorati i Kryeqytetit është njësi organizative në kuadër të Komunës së Prishtinës dhe nuk paraqet person juridik të veçantë. Për këtë arsye, kontrollues i të dhënave personale në kuptim të nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 të LMDhP-së është Komuna e Prishtinës, e cila, përmes njësisë së saj organizative – Inspektorati i Kryeqytetit – ka realizuar përpunimin e të dhënave personale.

Ligji në dispozitat e tij ka dhënë kuptimin se cilat veprime konsiderohen si përpunim i të dhënave personale, gjegjësisht neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të LMDhP-së, përcakton se me përpunim nënkuptojmë *“çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi”*. Në kontekstin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë së individit, publikimi i të dhënave personale nënkupton përpunim të të dhënave dhe si i tillë duhet të jetë i ligjshëm.

LMDhP në neni 4, ka paraparë parimet themelore për përpunimin e të dhënave personale, e një nga parimet e para të përpunimit është parimi i ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës ku sipas të cilit, të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme, të ligjshme dhe transparente, pa e cenuar dinjitetin e subjekteve të të dhënave. Pra, si parim shumë i rëndësishëm është ligjshmëria e përpunimit, por kjo nuk nënkupton se parimet tjera kanë më pak rëndësi por vetëm se me rastin e përpunimit të të dhënave personale si fillim duhet të shikuar ligjshmëria e përpunimit pastaj pasojnë parimet tjera me radhë siç janë: parimi i kufizimit të qëllimit, parimi i minimizimit të të dhënave, parimi i kufizimit të ruajtjes së të dhënave si dhe parimi i paprekshmërisë dhe konfidencialitetit. Parimi i minimizimit të të dhënave luan një rol të rëndësishëm, duke kërkuar që përpunimi i të dhënave të jetë adekuat, relevant dhe i kufizuar në atë që është domosdoshmërisht i nevojshëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara. Përpunimi i të dhënave që shkon përtej këtyre kufijve mund të mos ketë një bazë ligjore të vlefshme, duke cenuar kështu mbrojtjen e të dhënave personale.

Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale është kur zbatohet së paku një nga kriteret e paraparë në nenin 5 të LMDhP-së, me të cilën kontrolluesi do të legjitimonte përpunimin e të dhënave, që nënkupton se të dhënat personale duhet të përpunohen vetëm në përputhje me ligjin. Sipas nenit 5, paragrafi 1 të LMDhP-së, përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm vetëm nëse zbatohet, të paktën njëri nga kriteret si në vijim: 1.1. nëse subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij për përpunimin e të dhënave të tij personale për një ose më shumë qëllime specifike; 1.2. nëse përpunimi është i domosdoshëm për përmbushjen e një kontrate, në të cilën subjekti i të dhënave është palë kontraktuese ose për të ndërmarrë veprimet lidhur me kërkesën e subjektit të të dhënave para lidhjes së kontratës; 1.3. nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor, të cilit i nënshtrohet kontrolluesi; 1.4. nëse përpunimi është i domosdoshëm për mbrojtjen e interesave jetike të subjektit të të dhënave ose personave të tjerë fizikë; 1.5. nëse përpunimi është i domosdoshëm për kryerjen e një detyre me interes publik ose për ushtrimin e autoritetit zyrtar që i është dhënë kontrolluesit; 1.6. nëse përpunimi është i domosdoshëm për

qëllime të interesave legjitime të ushtruara nga kontrolluesi ose pala e tretë, përveç kur këto interesa tejkalohen nga interesat apo të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave që kërkon mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht nëse subjekti i të dhënave është fëmijë.

Agjencia pranon se informimi i qytetarëve për zbatimin e rregullave, masat inspektuese dhe shqiptimin e dënimeve mund të përbëjë qëllim legjitim të një autoriteti publik. Megjithatë, ekzistenca e një qëllimi informues nuk e bën automatikisht të ligjshëm publikimin e çdo të dhëne që gjendet në dokumentacionin administrativ. Kontrolluesi duhet të vlerësojë nëse i njëjti qëllim mund të arrihet pa identifikimin e personit dhe pa ekspozimin e të dhënave të tij personale. Edhe pse ekziston interes publik për informim lidhur me aktivitetet e inspektoratit dhe masat administrative të ndërmara nga autoritetet publike, mënyra e realizimit të publikimit ka rezultuar në tejkalim të qëllimit të informimit publik dhe cenim të të dhënave të subjektit të të dhënave.

Nga përmbajtja e materialit të publikuar rezulton se janë ekspozuar të dhëna personale që nuk kanë qenë të domosdoshme për arritjen e qëllimit të publikimit, përfshirë emrin dhe mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal, numrin e telefonit, adresën dhe fotografinë e subjektit të të dhënave. Publikimi i këtyre të dhënave në një platformë publike dhe të qasshme për një numër të pakufizuar personash përbën ndërhyrje të panevojshme dhe joproporcionale në privatësinë e individit. Një publikim në përputhje me legjislacionin në fuqi do të duhet të realizohet duke zbatuar teknika të minimizimit dhe anonimizimit të të dhënave personale, duke kufizuar informacionin e publikuar vetëm në atë që është e nevojshme për informimin e publikut. Në veçanti, publikimi i numrit personal përbën identifikues unik dhe paraqet rrezik të lartë personin fizik, pasi mund të çojë në keqpërdorim të të dhënave personale, identifikim të paautorizuar dhe cenim të sigurisë dhe privatësisë së individit. Po ashtu, kombinimi i emrit dhe mbiemrit, numrit të telefonit, targave të motoçikletës dhe fotografisë e ka bërë personin lehtësisht të identifikueshëm dhe ka rritur intensitetin e ndërhyrjes në privatësinë e tij.

Agjencia ka marrë parasysh edhe natyrën e platformës ku është kryer publikimi. Facebook është platformë me qasje të gjerë, ku përmbajtja mund të shikohet, shpërndahet, ruhet ose ripublikohet nga një numër i pacaktuar personash. Për këtë arsye, publikimi i të dhënave personale në një llogari publike ka potencial për përhapje të gjerë dhe humbje të kontrollit mbi të dhënat e publikuara.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, Agjencia konstaton se Komuna e Prishtinës, përmes njësisë së saj organizative – Inspektorati i Kryeqytetit, ka përpunuar në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 dhe nenin 5 të LMDhP-së, të cilat përcaktojnë parimin e ligjshmërisë, drejtësisë dhe transparencës, si dhe parimin e minimizimit të të dhënave. Ky veprim përbën kundërvajtje në kuptim të nenit 92, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1 të ligjit, duke konfirmuar se përpunimi i të dhënave është kryer pa bazë të mjaftueshme ligjore dhe në kundërshtim me parimet themelore të përpunimit.

Agjencia, për caktimin e vlerës së gjobës kundërvajtëse, ka marrë parasysh kriteret e përcaktuara në nenin 91, paragrafin 1 të LMDhP-së, me theks të veçantë natyrën, rëndësinë dhe kohëzgjatjen

e shkeljes, kategorinë e të dhënave personale, shkallën e bashkëpunimit me Agjencinë, masat të cilat janë ndërmarrë pas pranimit të informacionit mbi shkeljen, mënyrën se si Agjencia ka ardhur në informacion për shkeljen, respektimit të akteve të brendshme dhe çdo faktor tjetër lehtësues dhe rëndues.

Agjencia konsideron se gjoba kundërvajtëse e vendosur është efektive, që do të thotë se do të arrijë qëllimin për të ndëshkuar kontrolluesin për një shkelje të tillë, dhe si e tillë është proporcionale me shkeljen dhe është bindëse me qëllim që kontrolluesi në të ardhmen t'i shmanget sanksioneve të tilla, e rrjedhimisht të përpunojë të dhëna personale në pajtim me ligjin. Objektivi bazë i LMDhP-së është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë, në veçanti të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Agjencia për Informim dhe Privatësi, pas inspektimit të kryer dhe shqyrtimit të rastit, vërtetimit të gjendjes faktike dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

[Nënshkruar më datë 07.07.2026]

Zyrtare për Inspektim

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej 30 ditësh. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Komunës së Prishtinës, kontrollues,
- Arkivit të Agjencisë.